



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/274
Datë: 06.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafit 5, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë për "Instrumentin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor", ndërmjet Bashkimit Evropian, që përfaqësohet nga Komisioni Evropian si huadhënës, dhe Kosovës si huamarrës dhe Bankës Qendrore të Kosovës si Agjent i huamarrësit.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/274
Datë: 06.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit N. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në Ndërmarrjen Shoqërore si në vijim:
 - 1.1. Në Ndërmarrjen Shoqërore "Çeliku", në shumën 6,405€ (gjashtë mijë e katërqindpesë euro).
2. Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimi të këtyre të hyrave dhe nga llogaria kryesore e BRK dhe kthehen në llogaritë e ndërmarrjeve shoqërore sipas pikës 1. të këtij Vendimi, me qëllim që Ndërmarrja Shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat kreditore apo për të mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/274
Datë: 06.11.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafit 5, të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).
2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Për 
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet)

BLOKU KODJES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	Suma
1021628000/13/00000/0950	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	AKADEMIA DIPLOMATIKE	13	MALLERA DHE SHERBIME	150,000.00
1021628600/13/00000/0133	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	SHERBIET KONSULENTE	13	MALLERA DHE SHERBIME	1,000,000.00
Total - Kursime ne Malleta dhe Sherbime					1,150,000.00
1021614300/1400000/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	AMBASADAT - MPJ	14	SHPERZIME KOMUNALE	200,000.00
Total - Kursime ne Shperzime Komunele					200,000.00
102161131820/00000/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ	20	SUBVENZIONE DHE TRANSFERE	1,661,000.00
1021614500/20/00000/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	AMBASADAT - MPJ	20	SUBVENZIONE DHE TRANSFERE	335,040.00
Total - Kursime ne Subvencione dhe Transfere					1,996,100.00
102161131630/11073/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ	11073	MOBILE PER MPJ	65,580.00
102161131630/11074/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ	11074	KOMPUTER KABINETI MINISTRI	15,000.00
102161131630/11075/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ	11075	PAISJE TEKNOLOGJIKE	335,000.00
102161131630/12975/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ	12975	VEKTURA PER ADMINISTRA QENDRORE	5,250.00
1021614500/20/11076/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	AMBASADAT - MPJ	11076	AUTOMULETE PER AMBASADA	68,719.00
1021614300/20/19693/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	AMBASADAT - MPJ	19693	MOBILE PER OBJEKTET E AMBASADAVE	130,000.00
1021614300/20/19705/0113	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE	AMBASADAT - MPJ	19705	PAISJE TEKNOLOGJIKE KOMPUTER, PRINTER PER AMBA	150,000.00
Total - Kursime ne investime kapitale					770,579.00
Total - Kursime MPJD					4,116,679.00

Ameks B (Ndarjet)

BLLOKU KODUES	ORGANIZATA	PROGRAM	KAT	KATEGORIA	SHUMA
10216/1316/3/000000/13	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE DIA ADMINISTRATA QENDRORE - MPJ		13	MALLERA DHE SHERBIME	100.000.00
10216/14300/3/000000/13	MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE DIA AMBASADAT - MPJ		13	MALLERA DHE SHERBIME	4.016.679.00
Total - Ndarje MPJ D					4.116.679.00